

CONTINUO TOP ART

FINITURË TRANSPARENTE, BI-KOMPONENTE, AKRIL-URETHANE, ALIFATIKE ME BAZË UJI
Seri 121/126/127

PËRSHKRIMI

CONTINUO TOP ART janë finitura transparente bi-komponente akril-uretane me natyrë alifatike, që nuk zbehen, bazë uji, ideale për aplikim me rrul, pinel ose spruco, me efekt satin ose opak, ku kërkohet rezistencë e mirë ndaj ujit dhe likuideve në përgjithësi.

CONTINUO TOP ART garanton karakteristika me rezistencë të lartë kimike ndaj likuideve të ftohtë dhe të nxehtë, dhe ndaj shumë substancave që përdoren normalisht në zonë banimi dhe në restorante.

Finitura CONTINUO TOP ART komp. A përzihet me CONTINUO TOP komp. B dhe mjafton një përzierje manuale para përdorimit.

CONTINUO TOP komp. B është një katalit I gjeneratës së re, me bazë poliizocen alifatik, me një përmbajtje monomer, HDI <0.1% në peshë.

Finiturat CONTINUO TOP ART janë të disponueshme në versionin satin dhe shumë opake.

Sistemi CONTINUO është I klasifikuar A+ sipas dekretit ministerial francez për cilësinë e ajrit në ambiente të brendshme.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

-Sipërfaqe të punuara me CONTINUO DECO, para astarizimit (Iyerjes me astar) me CONTINUO LINK ose CONTINUO LINK ART.

-Sipërfaqe vertikale të veshura me smalte ose bojra/llaqe.

-Mobilje druri brenda, të reja ose të lyera më parë, si: parket, battiscopa, panele, objekte të ndryshme ku kërkohet fortësi sipërfaqësore.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

-CONTINUO TOP ART komp. A

-Natyra e lidhësit: dispersion poliuretan alifatik I modifikuar.

-Solventi: ujë

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1 komponenti A:

TOP ART SATIN: $1.05 \pm 0,05$ g/ml

TOP ART MAT: $1.20 \pm 0,05$ g/ml

CONTINUO TOP komp. B

-Natyra e lidhësit: poliizocen alifatik me përmbajtje monomeri HDI <0.1 % në peshë.

Përgatitja e përzierjes CONTINUO TOP ART SATIN

-Raporti I përzierjes në peshë: 10 pjesë nga komponenti A + 3 pjesë nga komponenti B.
2.5 L komponent A (1 paketim) + 0.75 L komponent B (1 paketim)

-Dendësia e përzierjes (A+B) UNI EN ISO 2811-1: 1.05 ± 0.03 kg/l

-Përzierja e përfutur hollohet në peshë/volum me ujë 0-10%.

Përgatitja e përzierjes CONTINUO TOP ART MAT

-Raporti I përzierjes në peshë: 12 pjesë nga komponenti A + 3 pjesë nga komponenti B.
2,5 L komponent A (1 paketim) + 0.75 L komponent B (1 paketim)

-Dendësia e përzierjes (A+B) UNI EN ISO 2811-1: 1.13 ± 0.03 kg/l

-Përzierja e përfutur hollohet në peshë/ volum me ujë 0-10%.

-Jetëgjatësia e përzierjes (A+B): rreth 60 minuta në 20 °C

Përzierja (A+B) edhe pse akoma e rrjedhshme (lëngët) nuk duhet të përdoret pasi të ketë kaluar koha e caktuar.

Për të përmirësuar ruajtjen e CONTINUO TOP komp. B pas hapjes, pastroni skajet dhe mbyllni mirë tapën duke e mbrojtur në këtë mënyrë nga lagështira dhe trupat e huaj.

-Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 30 min.; shtresa tjetër pas 3 orësh. Zmerilimi: pas 6 orësh.

Në sipërfaqe mund të bëhen kalime të rralla pas 12 orësh, tërësisht e kalueshme pas 24 orësh, arritja totale e vetive teknike arrihet pas 5 ditësh.

-Rezistenca ndaj abrazionit Taber: në 7 ditë, mola CS 17, 1000 gr, 500 xhiro (humbje në peshë)

CONTINUO TOP ART SATIN: <25 mg

CONTINUO TOP ART MAT: <35 mg

-Shkëlqimi UNI EN ISO 2813: CONTINUO TOP

ART SATIN: 20 ± 2 , këndi I leximit 60°

CONTINUO TOP ART MAT: 1 ± 1 , këndi I

leximit 85°

Shkëlqimi I bojrave/llaqeve, të matura në aplikim real në kantier, mund të rezultojë pak i ndryshëm nga ato të matura sipas parashikimit të normativës UNI EN ISO 2813.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sistemi dekorativ CONTINUO: shihni udhëzimet në skedën teknike përkatëse.

CONTINUO TOP ART

FINITURË TRANSPARENTE, BI-KOMPONENTE, AKRIL-URETHANE, ALIFATIKE ME BAZË UJI
Seri 121/126/127

Sipërfaqe druri të reja ose të lyera:

- Zmeriloni lehtësisht për të hequr fibrat e ngritura të drurit.
- Hiqni praninë e rezinës duke përdorur diluentin e përshtatshëm.
- Stukoni parregullsitë me stuko sintetike.
- Zmeriloni çarjet e stukuara dhe eliminoni pluhurat.
- Kontrolloni që druri të mos jetë shumë I lagësht.
- Zmeriloni sipërfaqen, pra vazhdoni me aplikimin e 2 shtresave CONTINUO TOP ART eventualisht duke zmeriluar nga njëra shtresë në tjetrën për të hequr fibrat e ngritura.
- Në dru të pasur me taninë, për të reduktuar formimin e njollave të errëta, aplikoni astarin UNIMARC PRIMER ANTITANNINO pa ngjyrë ose të bardhë seri 308 në bazë të efektit të kërkuar.

UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +45 °C

Lagështira relative e ambientit: <85%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +45 °C

Lagështira e sipërfaqes: <10%

- Mjetet: pinel, rrul me qime mesatare, spruco normale ose Airless.
- Hollimi: holloni përzierjen e përfutur (2,5 L nga komponenti A + 0,75 L nga komponenti B) duke shtuar 0,300-0,400 L me ujë, max 13% në peshë.
- Mos shtoni më shumë ujë për të zgjatur jetëgjatësinë.
- Përzieni (katalizoni) dhe përdorni një paketim për një herë (komp. A + komp. B).
- Nr shtresave: 2 shtresa.
- Për të shmangur formimin e hijeve, aplikoni produktin në vazhdimësi, duke shmangur kalimin në pjesët e thara.
- Pastrimi I mjeteve duhet të bëhet menjëherë me ujë pas përdorimit.
- Shkalla e mbulimit: influencohet shumë nga natyra dhe gjendja e sipërfaqes në mënyrë indikative 7-8 m²/l në dy shtresa, rreth 25 m² për të gjithë paketimin A+B të holluar në mënyrën e duhur në 2 shtresa.

NGJYROSJA

Produkti është I disponueshëm neutro, nuk ngjyroset.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30°C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5°C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/j: bojë bikomponente me performancë të lartë (bazë uji): 140 g/l (2010)
Produkti përmban max: 140 g/l VOC
Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos I hidhni mbetjet në ambient. I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të veçanta. Mos I hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Finiturë transparente bi-komponente akriluretaniqe me natyrë alifatike që nuk zbehen me bazë uji.
Rezistencë e lartë kimike ndaj likuideve të nxehtë dhe të ftohtë në përdorim normal në banesa civile dhe restorante, ndaj abrazionit dhe grafitit.
Aplikimi në të paktën 2 shtresa në sasi të përcaktuara nga absorbimi I sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.